



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 19.07.2023

Nr: 000-016

Ora: 13:08

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË EURO BALKANS NEWS, PËR AKREDITIMIN E DISA VËZHguesVE
PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot në datën 19.07.2023, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesat e:

KËRKUES: Euro Balkans News, me adresë në Rr. Rezervat e Shtetit, Lundër 1, Farkë, Tiranë;

OBJEKTI: Kërkohet akreditimi si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

BAZA LIGJORE: Nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë". Vendimi nr. 19, datë 27.01.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave".

V Ë R E J:

Euro Balkans News i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 1 vëzhguesve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre.

Kërkesa është paraqitur në datën 01.05.2023.

Nga përmbajtja e kërkesë si dhe e dokumentacionit shoqërues rezulton se ajo (kërkesa) nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 6 të Kodit zgjedhor.

a) Kërkuesi, nuk është një organizatë që gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, sikurse përcakton neni 6, pika 2 e Kodit Zgjedhor.

b) Kërkesa e paraqitur nuk respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor.

c) Dokumentacioni shoqërues i kërkesës nuk është në përputhje me përcaktimet e nenit 6, pika 4 e vijues të Kodit Zgjedhor

PËR KËTO ARSYE:

Si dhe në mbështetje të neneve 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 19, datë 27.01.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave",

V E N D O S A:

1. Mospranimin e kërkesës së Euro Balkans News për akreditimin e disa vëzhguesve për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI